



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:270811  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05641899

C.A.P.7669/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari individual Besnik Bislmaj, në çështjen juridike të kundërpërmbarrimit të debitorit, tani kreditor ish NSH Kolegji “A.. Xh.”, me seli në Ferizaj, tani Kolegji “U..” O.P, me seli në Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson V. Zh., avokat nga Prishtina, kundër kreditorit, tani debitor Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Inspektorati i Punës, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokatura Shtetërore, për përmbarrimin e dokumentit përmbarrimor, duke vendosur lidhur me ankesën e tani debitorit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.93/22, të datës 22.09.2022, më datë 26.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e debitorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Inspektorati i Punës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.93/22, të datës 22.09.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, ka vendosur si vijon: PRANOHET në tërësi propozimi për kundër përmbarrim i debitorit Kolegji “U..” O.P si bazuar, i ushtruar kundër kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës dhe URDHËROHET kreditori Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve- Inspektorati i Punës, që debitorit Kolegji “U..” O.P, t’ia kthejë mjetet dhe atë shumën prej 2,449.15 €, shumën e mjeteve prej 165 euro në emër të përpilimit të propozimit për kundër përmbarrim si dhe shumën e mjeteve prej 30 euro në emër të taksës gjyqësore për propozimin për kundër përmbarrim, brenda afatit prej 7 ditësh.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur debitori për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që ankesa e të njëjtit të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të anulohet ashtu që lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje dhe të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në afat prej 15 ditësh pas marrjes së vendimit përfundimtar.

Kreditori ndaj kësaj ankesë ka paraqitur përgjigje përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet ankimore me arsyetimin se pretendimet e të njëjtit janë të paqëndrueshme dhe se janë bërë me qëllim të zvarritjes së procedurës andaj ka propozuar që ankesa e debitorit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, nenit 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se:

*-Ankesa e debitorit është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ish NSH Kolegji "A. Xh.", me seli në Ferizaj, me datë 28.02.2022, pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, ka parashtruar propozim për përmbartim, kundër debitorit, në bazë të dokumentit përmbartimor, përkatësisht Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1330/2019, të datës 04.11.2021, përmes të cilit ka kërkuar që të lejohet kundër përmbartimi kundër debitorit ashtu që të detyrohet i njëjti që kreditorit t'ia paguajë shumën e përgjithshëm prej 2,449.15 €, me kamatë ligjore prej 8 %, të llogaritur që nga dita e përmbartimit e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata Themelore në Ferizaj duke vepruar sipas kundërpropozimit të kreditorit, me anë të aktvendimit e ka lejuar përmbartimin e propozuar sipas dokumentit përmbartimor si më lartë, duke e pranuar si dokument përmbartimor, i cili i plotëson kushtet për ta lejuar përmbartimin.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe mbajtjes së seancës dëgjimore publike, me aktvendimin e atakuar ka vendosur që ta pranojë si të bazuar propozimin për kundër përmbartim.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se "sipas dokumentit përmbartimor Aktgjykimit me të cilin është inicuar propozimi për kundër përmbartim është konstatuar se dokumenti përmbartues siç është vendimi për shqiptimin e gjobës nr.07/2019, i datës 16.01.2019 me nxjerrjen e Aktgjykimit A.nr.1330/2019, të datës 04.1.2021, i cili aktgjykim është i plotfuqishëm, është shfuqizuar dhe është bërë i pa efekt juridik dhe për këtë arsye gjykata konsideroj se rastin konkret janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 54, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenit 55.4 të LPP-së dje vendosi që ta pranoj propozimin për kundërpërmbartim të debitorit si dhe urdhëroj që kreditori brenda shtatë ditëve debitorit t'ia kthejë shumën e mjeteve prej 2,449.15 euro si dhe shpenzimet në shumë prej 156,00 euro, në emër të përpilimit të propozimit për kundërpërmbartim dhe shumën prej 30 eurove në emër të taksës gjyqësore."

Për mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 54, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 55, paragrafi 4 dhe 71 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, fillimisht i shqyrtoi pretendimet ankimore për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore me rastin e marrjes së aktvendimit, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të paqëndrueshme kjo për faktin se dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike duke iu referuar edhe dispozitave ligjore përkatëse. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare e në lidhshmëri me këtë ka nxjerrë edhe aktvendimin e atakuar tani me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës debitore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që në rastin konkret fillimisht qartësohet se kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit përmbartimor si në dispozitën e nenit 21 dhe nenin 22 të LPP-së që si i tillë paraqet titulli përmbartues sipas dispozitës së nenit 22, paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, në të cilin është përcaktuar se, si dokument përmbartues është edhe “*vendimi përmbartues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbartuese*”. Në rastin konkret titull përmbartues është Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.1330/2019, i datës 04.11.2021, i plotfuqishëm me datë 26.11.2021. Si dokument përmbartues në bazë të nenit 23 paragrafi 1, të LPP-së, është përcaktuar se “*sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit*” dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me vendim përmbartues të gjykatës siç përcaktohet me dispozita ligjore.

Meqenëse debitori me ankesë nuk ka paraqitur asnjë shkak me të cilin do të vërtetonte se ekzistojnë arsye të cilat do të bënin dokumentin të pa përshtatshëm për tu përmbartuar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin si të pabazuar duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, duke e konsideruar vendimin e gjykatës së shkallës së parë të drejtë dhe të ligjshëm.

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane, apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbartimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund t'i shkaktohet çfarëdo lloji dëmi me rastin e kryerjes së përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil, pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbartimit në këtë rast.

Me nenin 71 të LPP-së, janë paraparë shkaqet të cilat kundërshtimin e paraqitur ndaj aktvendimit për lejimin e përmbarimit do ta bënin të bazuar, andaj duke pasur parasysh se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga arsyet e parapara në nenet e lartcekura, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbarimore “në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (b) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.A.P.nr.7669/2022, më datë 26.04.2024.

Gjyqtari  
Besnik Bislimaj